EDUCO

Education for Development and Cultural Outreach

RAPORTI VJETOR 2025

RR. ZAHIR PAJAZITI NR.100
Prizren, Kosovë

ojqeduco.org

QASJA STRATEGJIKE GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, EDUCO ka ndjekur një qasje strategjike të integruar, duke ndërthurur edukimin, Trashëgiminë Kulturore dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Aktivitetet janë konceptuar në mënyrë që të nxisin mendimin kritik, përfshirjen qytetare dhe bashkëpunimin ndërsektorial.

Fokusi kryesor ka qenë:

- **fuqizimi i të rinjve përmes edukimit joformal**
- **lufta kundër diskriminimit dhe promovimi i barazisë**
- **ndërtimi i kapaciteteve në fushën e Trashëgimisë Kulturore**
- **bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi i përvojave**
- **zhvillimi i qëndrueshëm dhe planifikimi pjesëmarrës**

PROFILI I ORGANIZATËS EDUCO

EDUCO është një organizatë e shoqërisë civile që vepron në fushën e edukimit, kulturës dhe zhvillimit komunitar. Organizata fokusohet në edukimin joformal, aktivizmin qytetar, ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe promovimin e vlerave demokratike, duke bashkëpunuar ngushtë me të rinjtë, komunitetet lokale, institucionet publike dhe partnerë ndërkombëtarë.

Misioni
Të kontribuojë në zhvillimin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse përmes edukimit cilësor, pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe ruajtjes së Trashëgimisë Kulturore.

Vizioni
Një shoqëri ku të rinjtë dhe komunitetet lokale janë aktorë aktivë në ndërtimin e së ardhmes së qëndrueshme, në mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe në proceset vendimmarrëse.

FJALË HYRËSE

Viti 2025 për EDUCO përfaqëson një vit të rëndësishëm të vazhdimësisë, konsolidimit dhe zgjerimit të aktiviteteve në fushën e edukimit joformal, Trashëgimisë Kulturore, pjesëmarrjes qytetare dhe përfshirjes sociale.

Duke u mbështetur në përvojën e fituar gjatë viteve të kaluara dhe në vizionin afatgjatë të organizatës, EDUCO ka zhvilluar një sërë aktivitetesh që kanë synuar fuqizimin e të rinjve, ndërtimin e kapaciteteve profesionale dhe nxitjen e dialogut shoqëror mbi çështje me rëndësi publike.

Gjatë vitit 2025, organizata ka punuar në mënyrë të vazhdueshme për të krijuar hapësira edukative gjithëpërfshirëse, për të promovuar barazinë dhe për të ndërlidhur Trashëgiminë Kulturore me zhvillimin bashkëkohor dhe qëndrueshmërinë urbane.

Ky raport vjetor paraqet një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve të realizuara, rezultateve të arritura dhe ndikimit të tyre në komunitet.

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË VITIT 2025

AKADEMIA RINORE KUNDËR DISKRIMINIMIT

20–22 JANAR 2025 – PRIZREN
25–27 JANAR 2025 – SUHAREKË
19–21 SHKURT 2025 – RAHOVEC

Projekti “Akademia Rinore Kundër Diskriminimit” gjatë vitit 2025 u implementua në bashkëpunim nga OJQ DURMISH ASLANO / Radio Romano Avazo dhe OJQ EDUCO, si partnerë implementues. Projekti u realizua me përkrahjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Terre des Hommes – Kosovo, Voice of Roma, Ashkali and Egyptians dhe HEKS/EPER.

Ky bashkëpunim ndërmjet organizatave partnere dhe donatorëve kontribuoi në forcimin e dimensionit gjithëpërfshirës të akademisë, duke siguruar përfshirjen aktive të të rinjve nga komunitete të ndryshme dhe duke adresuar në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjet e diskriminimit, barazisë dhe të drejtave të njeriut.

Programi i Akademisë u fokusua në identifikimin e formave të diskriminimit, analizimin e rasteve konkrete dhe ndërtimin e aftësive për reagim qytetar dhe aktivizëm social. Përmes metodave interaktive, diskutimeve të hapura dhe punës në grupe, pjesëmarrësit zhvilluan aftësi kritike dhe ndjeshmëri sociale, duke u inkurajuar të kontribuojnë aktivisht në komunitetet e tyre.

Akademia krijoi gjithashtu një rrjet të qëndrueshëm të të rinjve të angazhuar, të cilët mbeten aktivë në iniciativa të ndryshme qytetare dhe kulturore.





PROGRAMI “HERITAGE READY”

HARTIMI I PLANIT TË MENAXHIMIT TË MUZEUT TË HIDROELEKTRANËS

PUNËTORIA I – 21 JANAR 2025, FUSHË KOSOVË
PUNËTORIA II – 28 SHKURT 2025, FUSHË KOSOVË

Punëtoritë në kuadër të programit “Heritage Ready: Funksionalizimi i Muzeut të Hidroelektranës” u realizuan në kuadër të projektit të mbështetur nga European Heritage Hub – Small Grants Scheme, me përkrahjen e ALIPH Foundation dhe Bashkimit Evropian.

Skema e granteve mbështetet nga ALIPH Foundation si partner shoqërues i European Heritage Hub, një projekt pilot i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian.

Mbështetja e dhënë mundësoi organizimin e punëtorive profesionale, trajnimeve praktike dhe diskutimeve me ekspertë të fushës, duke kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve lokale për menaxhimin e qëndrueshëm dhe funksionalizimin e trashëgimisë industriale.

Gjatë punëtorive u trajtuan tema kyçe si struktura organizative dhe menaxhimi operacional i muzeut, strategjitë për menaxhimin e rreziqeve, zhvillimi i programeve edukative dhe komunitare, si dhe branding-u, promovimi dhe marketingu i muzeut.

VIZITË STUDIMORE NË MUZEUN E HIDROELEKTRANËS

7 MARS 2025 – PRIZREN

Vizita studimore në Muzeun e Hidroelektranës shërbeu si vazhdimësi praktike e punëtorive "Heritage Ready". Pjesëmarrësit patën mundësi të njihen nga afër me hapësirat muzeale, të diskutojnë sfidat reale të menaxhimit dhe të reflektojnë mbi rolin e trashëgimisë industriale në edukimin bashkëkohor dhe zhvillimin lokal.

ERASMUS+ “ARTFUL MINDS”

16–22 SHKURT 2025 – VARSHAVË, POLONI

EDUCO mori pjesë në projektin ndërkombëtar Erasmus+ “Artful Minds”, i cili synonte shkëmbimin e praktikave të mira në fushën e artit, edukimit dhe mirëqenies mendore. Projekti mblodhi organizata nga vende të ndryshme evropiane, duke krijuar hapësirë për bashkëpunim, rrjetëzim dhe ndarje përvojash.

Pjesëmarrja në këtë projekt kontribuoi në forcimin e kapaciteteve të EDUCO-s dhe në integrimin e metodologjive të reja në programet lokale të organizatës.



WORKSHOP “FASILITIMI GRAFIK”

20 MARS 2025 – PRIZREN

Workshop-i “Fasilitimi Grafik” kishte për qëllim zhvillimin e aftësive vizuale si mjet komunikimi dhe edukimi. Pjesëmarrësit u njohën me teknika të vizualizimit të ideve dhe proceseve, duke mësuar si të përdorin vizatimin dhe elementet grafike për të lehtësuar diskutimet dhe proceset mësimore.

EUROPEAN HERITAGE HUB FORUM

3–4 PRILL 2025 – BUDVA, MALI I ZI

Përfaqësuesit e EDUCO morën pjesë në European Heritage Hub Forum, një platformë evropiane për dialog mbi politikat dhe praktikat e trashëgimisë kulturore. Forumi ofroi mundësi për shkëmbim përvojash dhe diskutim mbi rolin e organizatave të shoqërisë civile në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë.

PRIZRENI NË EPOKËN E RE

ARTEFAKTE ETNOLOGJIKE – 8–11 KORRIK 2025, PRIZREN
ARTEFAKTE ARKEOLOGJIKE – 14 KORRIK 2025, PRIZREN

Punëtoritë për restaurimin e Artefakteve Etnologjike dhe Artefakteve Arkeologjike synuan ndërtimin e kapaciteteve profesionale në fushën e ruajtjes së Trashëgimisë Kulturore.

Pjesëmarrësit u angazhuan në procese praktike restaurimi, duke u njohur me teknikat bazë, standardet profesionale dhe rëndësinë e ruajtjes së autenticitetit të materialeve kulturore.

Projekti u realizua me mbështetjen e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Komuna e Prizrenit.

CEREMONIA PËRMBYLLËSE

31 KORRIK 2025

Më 31 korrik 2025, EDUCO përmbylli me sukses projektin “Prizreni në Epokën e Re”, përmes një ceremonie përmbyllëse të organizuar në praninë e bashkëpunëtorëve, përfaqësuesve institucionalë dhe pjesëmarrësve të angazhuar në kuadër të projektit.

Ky projekt kishte për qëllim fuqizimin e kapaciteteve lokale në fushën e trashëgimisë kulturore, me fokus të veçantë në restaurimin dhe konservimin e artefakteve arkeologjike, si dhe në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e ruajtjes së Trashëgimisë Kulturore të qytetit të Prizrenit.

PRIZRENI I QËNDRUESHËM

25 NËNTOR 2025 – PRIZREN

Aktiviteti “Prizreni i qëndrueshëm: zhvillimi qarkor, zgjidhjet e bazuara në natyrë dhe planifikimi pjesëmarrës”, i realizuar në bashkëpunim me EC Ma Ndryshe, u fokusua në çështjet e zhvillimit urban të qëndrueshëm dhe përfshirjes qytetare në planifikimin e qytetit.

TRASHËGIMIA KULTURORE PËR TË GJITHË

19 DHJETOR 2025 – PRIZREN

Aktiviteti përmbyllës i vitit 2025 theksoi rëndësinë e aksesit të barabartë në trashëgimi kulturore dhe rolin e saj në ndërtimin e identitetit dhe kohezionit social. Aktiviteti synoi përfshirjen e grupeve të ndryshme shoqërore dhe promovimin e trashëgimisë si vlerë e përbashkët.

PËRMBLEDHJE

Gjatë vitit 2025, EDUCO ka realizuar një sërë aktivitetesh Edukative, Kulturore dhe Komunitare, duke krijuar ndikim të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë në komunitetet lokale dhe tek të rinjtë.
Përmes qasjeve gjithëpërfshirëse dhe metodave të edukimit joformal, aktivitetet e realizuara kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve individuale dhe institucionale, si dhe në forcimin e dialogut qytetar.

Programet e EDUCO-s kanë ndikuar në:

- Fuqizimin e të rinjve përmes edukimit qytetar, aktivizmit social dhe luftës kundër diskriminimit
- Ndërtimin e kapaciteteve profesionale në fushën e Trashëgimisë Kulturore, restaurimit dhe menaxhimit të saj
- Rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e Trashëgimisë Kulturore si pjesë e identitetit dhe zhvillimit lokal
- Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile, institucioneve publike dhe partnerëve ndërkombëtarë
- Nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe planifikimit pjesëmarrës në nivel lokal.

PËRMBLEDHJE

Gjatë vitit 2025, EDUCO ka realizuar një sërë aktivitetesh Edukative, Kulturore dhe Komunitare, duke krijuar ndikim të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë në komunitetet lokale dhe tek të rinjtë.
Përmes qasjeve gjithëpërfshirëse dhe metodave të edukimit joformal, aktivitetet e realizuara kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve individuale dhe institucionale, si dhe në forcimin e dialogut qytetar.

Programet e EDUCO-s kanë ndikuar në:

- Fuqizimin e të rinjve përmes edukimit qytetar, aktivizmit social dhe luftës kundër diskriminimit
- Ndërtimin e kapaciteteve profesionale në fushën e Trashëgimisë Kulturore, restaurimit dhe menaxhimit të saj
- Rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e Trashëgimisë Kulturore si pjesë e identitetit dhe zhvillimit lokal
- Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile, institucioneve publike dhe partnerëve ndërkombëtarë
- Nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe planifikimit pjesëmarrës në nivel lokal.

FALENDERIME

Organizata Joqeveritare EDUCO shpreh mirënjohjen e saj të thellë për të gjithë institucionet, partnerët dhe individët që kanë kontribuar në realizimin e aktiviteteve gjatë vitit 2025.

Falënderojmë Komunën e Prizrenit, në veçanti Drejtorinë për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik (DTZHE) dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS), për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme në realizimin e projekteve dhe aktiviteteve kulturore dhe edukative.
Mirënjohje të veçantë shprehim për Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prizren (QRTK Prizren) për mbështetjen profesionale dhe institucionale në fushën e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore.

Falënderojmë Bashkimin Evropian për mbështetjen e dhënë në kuadër të projekteve që kontribuojnë në fuqizimin e kapaciteteve lokale dhe zhvillimin e qëndrueshëm, si dhe ALIPH Foundation për përkrahjen në funksionalizimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
Një falënderim i veçantë u dedikohet partnerëve tanë të programeve Erasmus+, për bashkëpunimin ndërkombëtar, shkëmbimin e përvojave dhe kontributin në zhvillimin profesional dhe institucional të organizatës.

EDUCO shpreh mirënjohje të sinqertë për vullnetarët tanë, angazhimi dhe përkushtimi i të cilëve ka qenë thelbësor për realizimin me sukses të aktiviteteve gjatë vitit 2025.
Në fund, falënderojmë të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët e tjerë, të cilët, edhe pse nuk janë përmendur individualisht, kanë kontribuar në mënyra të ndryshme në mbështetjen dhe realizimin e misionit të EDUCO-s.

NA NDIQNI

Për më shumë informata rreth aktiviteteve, projekteve dhe iniciativave tona, na ndiqni dhe na vizitoni në platformat tona zyrtare:

Website
ojqeduco.org
kontur.ojqeduco.org

Instagram
@ojq.educo

Facebook
ojq.educo

LinkedIn
linkedin.com/company/ojqeduco

TikTok
tiktok.com/@ojq.educo

Spotify
open.spotify.com/ojq.educo

EDUCO

Education for Development and Cultural Outreach